



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.
_____.2021

Tiranë, më

VENDIM

Nr. 421, datë 29.09.2021

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIU DHËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

EKSTRAKT

RAPORT

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) E
GJYQTARES
{...}

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë aspekt dhe dy treguesit që e përbëjnë atë, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të q{...} për zbatimin e saj në rastin konkret. Në të drejtën civile gjyqtarja {...} zgjidh drejt mosmarrëveshjet objekt gjykimi dhe vendimi i dhënë prej saj lihet ne fuqi nga gjykatat më të l{...}, ose nuk ankimohet nga palët (shih dokumentet 1-3 dhe dosjen 1). Gjithashtu në të drejtën civile gjyqtarja ka njohuri të mira në lidhje me paditë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv (shih dokumentin 1), njeh paditë për dëmshpërblimin që rrjedh nga marrëdhëniet e punës (shih dokumentin 3 dhe dosjen 1). Në të drejtën familjare gjyqtarja {...} njeh dhe zbaton dispozitat për zgjidhjen e martesës, lëshimin e urdhrit të mbrojtjes sipas ligjit nr. 9669, datë 17.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (shih dosjet 2 dhe 3). Në rastin e kërkesës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, gjyqtarja respekton afatet ligjore për shqyrtimin e çështjes dhe afatet për zbardhjen e vendimit në kohë. Në të drejtën penale gjyqtarja manifeston njohuritë e duhura në drejtim të cilësimit juridik të veprës penale, dhe përgjithësisht, respekton kriteret e nenit 47 të K. Penal në caktimin e llojit dhe masës së dënimit ndaj të pandehurit kur provohet fajësia e tij (shih analizën e dosjes 4). Njeh dhe zbaton alternativat e dënimit me burgim (shih dosjen 4). Në të drejtën procedurale njeh dhe zbaton dispozitat mbi masat e sigurimit në rastin e kërkesave për ekstradim të personave të dënuar në vende të tjera, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare ne fuqi në R. Sh(shih dosjen 5); aplikon kur është rasti gjykimin e posaçëm (gjykimin e shkurtuar) kur çmon se janë kushtet e nenit 404 të K.Pr.P (shih dosjen 4).”*

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSË KONFIKTON E NORMAVE POLI I DREJTËSISË

RRUGA “ANA KOMNENA”

TIRANË

shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike "*Iura novit curia*" – "*Gjykata e njeh ligjin*". Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton përshkrimi i qartë i fakteve të çështjes në pjesën hyrëse të vendimit, në përputhje me provat e administruar gjatë gjykimit. Karakteristikë e përshkrimit të faktit në vendimet e analizuara, është përshkrimi i rrethanave të çështjes duke integruar përmbajtjen e provave të administruara. Provueshmëria e çdo elementi apo rrethane të caktuar të bashkësisë së fakteve, lidhet me provën e shqyrtuar e vlerësuar si të tillë. Kjo metodologji e përdorur në pasqyrimin e fakteve e sjell këtë të fundit gjithmonë të integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

Gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme përshkrimit dhe analizës së faktit juridik (*civil apo penal*), në mënyrë të pavarur, duke iu referuar përmbajtjes dhe posaçërisht vlerësimit të provave në mënyrë të pavarur, në disa raste duke u ndaluar dhe në analizën e dispozitave procedurale në lidhje me vlerën provuese të tyre¹. Gjithashtu gjyqtarja, në nxjerrjen e faktit juridik, bazohet jo vetëm në provat e paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse por edhe provat të mara kryesisht nga gjykata, siç është rasti i akteve të ekspertimit në ato raste kur për zgjidhjen sa më drejtë të çështjes nevojiten njohuri të posaçme². Në lidhje me faktet e çështjes, karakteristike e metodologjisë së të shkruarit të vendimit gjyqësor, është rimarrja dhe analiza e fakteve në mënyrë specifike dhe për aq sa është e nevojshme në shërbim të arsyetimi ligjor të çështjes si dhe në pjesën e analizës së pretendimeve të palëve ndërgjyqëse.³ Në të gjitha vendimet konstatohet se gjyqtarja tregon kujdesin e duhur, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile të bëjë një

¹ Vendimi nr. 1178, datë 21.09.2015 në të cilin analizohet nenit 262 i Kodit të Procedurës Penale për të çmuar vlerën provuese të shkresës së thjeshtë.

² Vendimi nr. 712, datë 05.06.2014 dhe vendimi nr. 1108, datë 06.10.2014 në të cilët është kryer akti i ekspertimi psikologjik.

³ Vendimi nr. 1178, datë 21.09.2015.

cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi, si dhe për të bërë kualifikimin e duhur ligjor të faktit penal, në raport me dispozitat e ligjit penal material⁴.

-Identifikimi i natyrës së çështjes:

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjykata krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale. Gjyqtarja, pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, e cila jo në çdo rast është bërë në mënyrë të shprehur, por rezulton nga objekti i padisë apo çështjes, përcakton qartë edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*mosmarrëveshje në lidhje me përmbushjen e detyrimeve kontraktore, pavlefshmëri titulli ekzekutiv apo marrëdhënie pune*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj, apo masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*), si dhe llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjet penale (vepra penale e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal) apo natyra e kërkesave penale objekt shqyrtimi (*vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*).

Referuar burimeve të vlerësimit në tërësi, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësinë e duhur përcaktimit të qartë të natyrës së çështjes, përcaktim i cili determinon drejtpërdrejtë vlerësimin lidhur me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, element i cili pasqyrohet pothuajse në të gjitha vendimet burim vlerësimi (*si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale*) në pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit duke konkluduar shkurtimisht lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e saj për shqyrtimin e çështjes. Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes edhe ku nuk është identifikuar në mënyrë shprehur, del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kriterëve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi.

Në çështje të caktuara, në të cilat përcaktimi i natyrës së mosmarrëveshjes ka qenë determinant për të orientuar arsyetimin e vendimit dhe për pasojë, zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi specifike vlerësimit dhe arsyetimit lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes, siç është rasti i përcaktimit të kërimit për përmbushjen e detyrimit kontraktor, duke përkufizuar marrëdhënien kontraktore të palëve si një kontratë shërbimi atipike, apo në çështjet lidhur me marrëdhëniet e punës, në të cilat pa u lidhur me pretendimet e palëve ndërgjyqëse⁵, gjyqtarja analizon dhe përcakton institutin respektiv të Kodit të Punës, mbi bazën e të cilit do të zgjidhet çështja objekt shqyrtimi⁶.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

⁴ Vendimi nr. 766, datë 22.10.2015 dhe vendimi nr. 712, datë 12.10.2015.

⁵ Vendimi nr. 780, datë 02.02.2015.

⁶ Vendimi nr. 865, datë 23.06.2015, vendimi nr. 455, datë 07.04.2015, vendimi nr. 350, datë 23.03.2016 dhe vendimi nr. 1178, datë 21.09.2015.

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke identifikuar vetëm ato dispozita kanë lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, të cilat më pas i nënshtrohen edhe analizës së tyre, për aq sa është vlerësuar e nevojshme në dobi të konkluzionit të saj lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material edhe procedural të evidentuar për zgjidhjen e çështjeve dhe situatave procedurale, rezulton si më poshtë:

(1) **Në vendimet civile** (*mosmarrëveshje kontraktore, pavlefshmëri titulli ekzekutiv, marrëdhënie pune, zgjidhje martese, apo lëshim urdhër mbrojtje, etj.*), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar dispozitave materiale të Kodit Civil, të Kodit të Procedurës Civile në rastin e pavlefshmërisë së titullit, Kodit të Punës, Kodit të Familjes, por edhe ligjeve specifike përkatëse që kanë lidhje me mosmarrëveshjen. Konkretisht:

- (i) *Në çështjen më objekt pavlefshmëri e titullit ekzekutiv,*⁷ gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale njëkohësisht (*nenin 609 të K.Pr.Civile*) në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv.
- (ii) *Në çështjen me objekt përmbushjen e detyrimeve kontraktore,* gjyqtarja identifikon dispozitat specifike të Kodit Civil që lidhen me natyrën e marrëdhënies juridike mes palëve dhe ekzekutimi i detyrimeve kontraktore (*nenet 450,422,455,698, 463 të Kodit Civil*).
- (iii) *Në çështjet që lidhen me marrëdhëniet e punës*⁸, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale relevante për çdo çështje, në raport me llojin e marrëdhënies së punës dhe mënyrën e zgjidhjes së saj dhe konkretisht *nenet 140, 143, 153, 144, 155, 145, 11, 148, 138 të Kodit të Punës*). Në këto çështje, gjyqtarja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm edhe aktet ligjore dhe nënligjore specifike në shërbim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe konkretisht, *nenin 9 të ligjit nr. 7926, datë 20.04.1995 për të vlerësuar lidhur me vazhdimësinë e detyrimeve ndaj punëmarrësit në rastin e ndryshimit apo transformimit të punëdhënësit*⁹, *Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 01.02.2012 "Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të shoqërisë Albpetrol sh.a Patos", Udhëzimi nr. 12, datë 03.09.2013 i METE*¹⁰.
- (iv) *Në çështjet me objekt zgjidhje martese si dhe në ato që lidhen me ndryshimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore*¹¹, gjyqtarja identifikon dispozitat e Kodit të Familjes që gjejnë zbatim lidhur me zgjidhjen e martesës dhe pasojat e saj në raport me bashkëshortët, si dhe dispozitat në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për fëmijët e mitur, duke identifikuar në shërbim të analizës ligjore *nenet 5, 159,155,158,215, 1, 50, 132, 133, 146, 132, 201 të Kodit të Familjes*. Në mënyrë specifike, në vendimet që lidhen me përcaktimin e përgjegjësisë prindërore për fëmijët e mitur, krahas dispozitave të Kodit të Familjes, gjyqtarja identifikon si ligj të

⁷ Vendimi nr. 181, datë 09.02.2015.

⁸Vendimi nr. 865, datë 23.06.2015, vendimi nr. 455, datë 07.04.2015, vendimi nr. 350, datë 23.03.2016 dhe vendimi nr. 1178, datë 21.09.2015.

⁹ Vendimi nr. nr. 350, datë 23.03.2016.

¹⁰ Vendimi nr. 350, datë 23.03.2016, vendimi nr. 455, datë 07.04.2015.

¹¹Vendimi nr. 1108, datë 06.10.2014, vendimi nr. 1299, datë 13.10.2015 dhe vendimi nr. 712, datë 05.06.2014.

zbatueshëm nenin 3 të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijëve”, në lidhje me përcaktimin dhe më pas interpretimit e parimit të interesit më të lartë të fëmijës¹².

- (v) *Në çështjet me objekt lëshim urdhër mbrojtje dhe verifikim i urdhrat të mbrojtjes*¹³, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 1, 10 dhe 3 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar në lidhje me identifikimin e subjekteve ndaj të cilat zbatohet ky ligj si dhe në raport me masat e vlerësuara si të përshtatshme në rastin konkret.

Në vendimet gjyqësore civile evidentohet identifikimi i dispozitave procedurale civile të cilat kanë lidhje, si më zgjidhjen përfundimtare të çështjes, ashtu edhe në funksion të zgjidhjes së kërkesave procedurale apo vlerësimit të elementeve procedurale në lidhje me përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes apo vlerën e provave. Konkretisht identifikohet:

- (i) Neni 609 i Kodit të Procedurës Civile në lidhje me përcaktimin e rasteve të pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv¹⁴;
- (ii) Neni 90/2 i K.Pr.C në lidhje me legjitimitetin aktiv të paditësit¹⁵;
- (iii) Nenin 106 të K.Pr.C në lidhje me përcaktimin e detyrimit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore në raport me disponimin për padinë¹⁶;
- (iv) Nenet 442 dhe 443 të K.Pr.C në lidhje me afatin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë në rastet e padive me objekt pavlefshmëri titulli ekzekutiv¹⁷;
- (v) Neni 185 i K.Pr.C në lidhje me ndryshimin e objektit të padisë¹⁸;
- (vi) Nenin 16 të K.Pr.C në lidhje me vlerësimin dhe përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes nga gjykata, pa u lidhur me përcaktimet e palëve, duke identifikuar në këtë drejtim edhe Vendimin Unifikues nr. 5, datë 30.10.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë¹⁹;
- (vii) Nenin 262 të K.Pr.C në lidhje me përcaktimin e vlerës provuese të shkresës së thjeshtë.

Në të gjitha rastet e sipër përmendura, gjyqtarja ka disponuar lidhur me kërkesat procedurale apo çështjet procedurale të marra në analizë kryesisht prej saj, në përputhje me faktin, provat dhe dispozitën relevante procedurale përkatëse, duke bërë edhe interpretimin e dispozitave procedurale të referuara. Po kështu citohen dispozitat procedurale civile (*nenet 36/1, 41, 42, 43, 45*), por edhe në ligjet e posaçme (*p.sh. nenet 9/1 dhe 12/1 i ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 « Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare »*) në lidhje përcaktueshmërinë e juridiksionit dhe kompetencës lëndore dhe tokësore të shqyrtimit të çështjes.

(2) Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, ashtu edhe dispozitave të përgjithshme të kodit penal në lidhje me përcaktimin e llojit dhe masën e dënimit si dhe aplikimin e alternativave të dënimit me burgim. Konkretisht:

¹² Vendimi nr. 1108, datë 06.10.2014 dhe vendimi nr. 712, datë 05.06.2014.

¹³ Vendimi nr. 1299, datë 13.10.2015 dhe vendimi nr. 14, datë 23.10.2014.

¹⁴ Vendimi nr. 181, datë 09.02. 2015.

¹⁵ Vendimi nr. 181, datë 09.02. 2015.

¹⁶ Vendimi nr. 181, datë 09.02. 2015, vendimi nr. 1178, datë 21.09.2015, vendimi nr. 712, datë 05.06.2014.

¹⁷ Vendimi nr. 181, datë 09.02. 2015.

¹⁸ Vendimi nr. 1178, datë 21.09.2015.

¹⁹ Vendimi nr. 1178, datë 21.09.2015, vendimi nr. 780, datë 02.02.2015.

- (i) Identifikon nenin 291 të K. Penal në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale të “Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”²⁰, duke referuar dhe nenet 52, 184 dhe 115 të Kodit Rrugor;
- (ii) Identifikon nenin 14 të Kodit Penal në lidhje me përcaktimin e moshës për përgjegjësi penale²¹;
- (iii) Identifikon dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal në lidhje me kriteret e përcaktimit të llojit dhe masës së dënimit me qëllim individualizimin e tij (nenet 47 dhe 48 të K. Penal)²²;
- (iv) Identifikon nenet 59²³ dhe 63²⁴ të Kodit Penal në lidhje me kushtet dhe kriteret e aplikimit të alternativave të dënimit me burgim.

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtarja ka referuar në çdo rast, si pjesë e integruar e arsytimit të vendimit, dispozita të ligjit procedural penal (nenet 69, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale) në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës²⁵, procedurën e gjykimit të shkurtuar (nenet 403 - 406 të K.Pr.Penale)²⁶; dispozitat procedurale lidhur me masat e sigurimit në rastin e aplikimit të dënimeve alternative (nenin 389 të K.Pr.Penale)²⁷.

Në vendimin me objekt miratimin e arrestit dhe caktim mase sigurimi²⁸ në kuadër të kërkesës për ekstradim, gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të vlerësimit të kompetencës lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e kërkesës për caktim mase sigurimi për efekte ekstradimi (neni 494/3 i K.Pr.P); analizës së ligjshmërisë së arrestimit (nenin 448 dhe 493 të K.Pr.Penale) dhe vlerësimit që i bëhet kriterëve kumulative për vendosjen e masës së sigurimit në kuadër të procedimit për ekstradim (neni 495/3 i K.Pr.Penale). Në lidhje me sa më sipër, gjyqtarja përveç dispozitave procedurale, identifikon si ligj të zbatueshëm nenin 39/2 të Kushtetutës, si dhe Konventën Evropiane “Për ekstradimin, datë 13.12.1957, Konventën Evropiane “Për ndihmë të ndërsjellët juridike në çështjet penale” ratifikuar me ligjin nr. 9871, datë 11.02.2008 dhe Marrëveshjen mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë si shtese e Konventës Evropiane “Për ekstradimin”.

Nga ana tjetër, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast konflikt i normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes në mënyrë të integruar me provat e administruara në gjykim, si dhe të identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo çështjes penale konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

²⁰Vendimi nr. 712, datë 12.10.2015 dhe vendimi nr. 766, datë 22.10.2015.

²¹ Vendimi nr. 712, datë 12.10.2015.

²²Vendimi nr. 712, datë 12.10.2015 dhe vendimi nr. 766, datë 22.10.2015.

²³ Vendimi nr. 766, datë 22.10.2015

²⁴ Vendimi nr. 712, datë 12.10.2015.

²⁵Vendimi nr. 712, datë 12.10.2015 dhe vendimi nr. 766, datë 22.10.2015.

²⁶Po aty.

²⁷Po aty.

²⁸Vendimi nr. 73, datë 26.01.2014.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës ligjore (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) por edhe i dispozitave procedurale në raste të caktuara, si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj mbi faktet e çështjes apo aspektet procedurale objekt vlerësimi.

Normat ligjore citohen në shumicën e vendimeve të analizuara, duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile dhe të cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit në çështjet penale.

Gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin teleologjik të normës konkrete (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*), por edhe interpretimin sistematik të normave dhe, duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, nxjerr konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe arsyet mbi mënyrën e zbatimit të normës konkrete.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

(1) Në vendimet civile: Përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin dhe duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim norma ligjore e identifikuar, por në

përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se:

- (i) Në përcaktimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik (vendim gjyqësor civil), gjyqtarja interpreton nenin 609 të K.Pr.C, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që mund të sjellin pavlefshmëri të tij, duke integruar në interpretim edhe dhënien e kuptimit të nenit 7 të K.Pr.C në raport me përcaktimin e termit “fakt”, të përdorur nga ligjvënësi në përmbajtje të nenit 609 të këtij Kodi²⁹. Interpretimi teleologjik që ka në fokus përcaktimin e qëllimit të ligjvënësit në përcaktimin e shkaqeve që mund të sjellin pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor, kur ai është kthyer në titull ekzekutiv, bëhet duke dhënë kuptimin e dispozitës dhe posaçërisht kuptimin e togfjalëshit “fakte të ngjara pas dhënies së vendimit”, në funksion të vlerësimit lidhur me bazueshmërinë e pretendimeve të palës paditëse.
- (ii) Në funksion të cilësimit të llojit të marrëdhënies juridike të punës dhe posaçërisht të përcaktimit të mënyrës së zgjidhjes/përfundimit të saj, gjyqtarja interpreton nenin 140 të Kodit të Punës për përcaktimin e kohëzgjatjes së kontratës së punës; nenin 148 të K.Punës lidhur me përcaktimin e kushteve ligjore për klasifikimin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës në kuadër të pushimit kolektiv nga puna; nenet 143, 144, 153, 155 dhe 145 të Kodit të Punës lidhur me përcaktimin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës për shkaqe të justifikuara ose jo, afatin dhe procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës, përcaktimin e zgjidhjes si me efekte të menjëhershme, si dhe pasojat e zgjidhjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të menjëhershme të pajustificuar apo pretendimet për shpërblimin në vjetërsi në punë, në varësi të mënyrës së zgjidhjes apo përfundimit të marrëdhënies së punës³⁰. Në këto çështje, gjyqtarja ka marrë në analizë dhe ka interpretuar, në raste specifike edhe parashikime të akteve ligjore dhe nënligjore të tjera që gjejnë zbatim, siç është rasti i interpretimit dhe analizës së nenit 156 të Kodit të Punës në lidhje me përgjegjësinë e punëmarrësit në rast se marrëdhënia e punës zgjidhet me vullnet të tij³¹; interpretimi i pikës 1 dhe 3 të VKM nr. 106, datë 01.02.2012 në raport me parashikimet e nenit 145 të Kodit të Punës ; interpretimi i nenit 152 dhe 153 të këtij Kodi në lidhje me institutin e heqjes dorë nga përfitimi i shpërblimit të përcaktuar në VKM, në rastin e aplikimit të saj në kuadër të ristrukturimit të ndërmarrjes³²; interpretimi i nenit 9 të ligjit nr. 7926, datë 20/04/1995 në lidhje me natyrën e vazhdueshme të detyrimeve në kuadër të marrëdhënies punëdhënës-punëmarrës, në rastet e ndryshimit të formës së organizimit të punëdhënësit³³.
- (iii) Gjyqtarja interpreton nenin 132 të Kodit të Familjes me qëllim analizimin e shkaqeve ligjore të zgjidhjes së martesës, në funksion të përcaktimit të shkakut konkret në çdo çështje të kësaj natyre, në raport me provat dhe pretendimet e palëve³⁴; interpreton nenin 133 të Kodit të Familjes në funksion të konkluzionit se përcaktimi fajësisë vendoset nga gjykata vetëm me kërkesë të palëve ndërgjyqëse³⁵.
- (iv) Në funksion të analizës lidhur me pasojat e zgjidhjes së martesës në raport me përgjegjësinë ndaj fëmijëve të mitur, gjyqtarja interpreton nenin 3 të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijëve”, së bashku me nenin 5 dhe 155 të Kodit të Familjes, me qëllim përcaktimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës si parim themelor që përcakton vlerësimin e gjykatës në lidhje

²⁹ Vendimi nr. 181, datë 09.02.2015.

³⁰ Vendimi nr. 350, datë 23.03.2016, vendimi nr. 455, datë 07.04.2015, vendimi nr. 1178, datë 21.09.2015 dhe vendimi nr. 865, datë 23.06.2015.

³¹ Vendimi nr. 1178, datë 21.09.2015.

³² Vendimi nr. 455, datë 07.05.2015.

³³ Vendimi nr. 350, datë 23.03.2016.

³⁴ Vendimi nr. 1108, datë 06.10.2014, vendimi nr. 1299, datë 13.01.2015.

³⁵ Po aty.

me çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët e mitur³⁶ dhe përcaktimin e modalitete të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës apo në rastet kur objekt kërkimi është ndryshimi i tyre. Në kuadër të këtij vlerësimi, gjyqtarja ka interpretuar edhe nenin 215 të Kodit të Familjes, për të evidentuar dhe dhënë kuptimin e mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe natyrën e ndryshueshme të vendimeve gjyqësore në lidhje me këtë aspekt, në eventualitetin e ndryshimit të kushteve të jetesës dhe nevojave të fëmijës³⁷.

- (v) Me qëllim përcaktimin dhe dhënien e kuptimit të subjekteve të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, me qëllim përcaktimin e legjitimitetit aktiv dhe pasiv të palëve ndërgjyqëse, gjyqtarja ka interpretuar nenin 3 të këtij ligji, duke u fokusuar në interpretimin logjik të normës me qëllim dhënien e kuptimit të termit “pjesëtare të familjes” apo “marrëdhënie familjare”³⁸. Po ashtu, në këto çështje, gjyqtarja ka interpretuar nenin 3/1 të ligjit të posaçëm me qëllim dhënien e kuptimit të termit “dhunë” dhe vlerësimin e fakteve dhe rrethanave konkrete të çështjes, në raport me kuptimin e këtij koncepti³⁹. Me qëllim përcaktimin e masave të përshtatshme për të garantuar mbrojtjen e viktimës, gjyqtarja interpreton nenin 1 të ligjit të posaçëm, duke evidentuar dhe analizuar natyrën, qëllimi dhe proporcionalitetin e masave mbrojtëse, në raport me situatën konkrete mes palëve ndërgjyqëse⁴⁰.

Në disa prej vendimeve civile burim vlerësimi, gjyqtarja ka interpretuar edhe norma procedurale të vlerësuara si të zbatueshëm në lidhje me çmuarjen e vlerës së provës shkresore (interpreton nenin 262 të K.Pr.C në lidhje me shkresën private)⁴¹; në lidhje me barrën e provës (jep kuptimin e nenit 6 të K.Pr.C në raport me barrën e provës për palën që ngre pretendimin para gjykatës)⁴²; në lidhje me afatin e ankimit për vendimin gjyqësor lidhur me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv (interpreton nenet 442, 443 dhe 452 të K.Pr.C) në funksion të përcaktimit të afatit të ankimit në raport me natyrën përfundimtare të vendimit në rastin konkret⁴³.

(2) *Në vendimet penale*: Gjyqtarja interpreton dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe përcaktimin e elementëve të figurës së veprës penale. Kryesisht konstatohet se gjyqtarja, pas citimit, interpreton nenin 291 të Kodit Penal (*identifikuar si norma materiale e zbatueshme në të dy vendimet penale të analizuar*), duke dhënë kuptimin e normës nëpërmjet evidentimit të objektit, anës objektive, subjektit dhe anës subjektive të figurës së veprës penale konkrete. Ky interpretim, sa i përket elementëve të anës objektive, shoqërohet me referim dhe analizë edhe të dispozitave specifike të Kodit Rrugor që përcaktojnë shkeljen përkatëse⁴⁴. Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, evidentohet edhe interpretimi i dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, kryesisht në lidhje me individualizimin e dënimit (*nenet 47 dhe 48 të K. Penal*) si dhe kushtet dhe kriteret ligjore të

³⁶ Vendimi nr. 1108, datë 06.10.2014, vendimi nr. 1299, datë 13.01.2015 dhe vendimi nr. 712, datë 05.06.2014.

³⁷ Vendimi nr. 712, datë 05.06.2014

³⁸ Vendimi nr. 22, datë 13.03.2015 dhe vendimi nr. 14, datë 23.10.2014.

³⁹ Vendimi nr. nr. 14, datë 23.10.2014.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Vendimi nr. 1178, datë 21.09.2015.

⁴² Po aty.

⁴³ Vendimi nr. 181, datë 09.02.2015.

⁴⁴ Vendimi nr. 755, datë 22.10.2015 dhe vendimi nr. 712, datë 12.10.2015.

aplikimit të alternativave të dënimit (nenet 59 dhe 63 të K. Penal)⁴⁵. Në këto raste, gjyqtarja është ndalet veçanërisht në qëllimin, funksionin dhe kushtet që duhet të përmbushen për aplikuar një masë dënimi alternative sipas parashikimeve të nenin 59 ose 63 të K. Penal.

Për sa i përket interpretimit të dispozitave penale, gjyqtarja është ndalur ne interpretimin e nenit 494 dhe 495 të K.Pr.P në lidhje me përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme për aplikimin e masave të sigurimit në kuadër të procedurave të ekstradimit, veçanërisht të masës së sigurimit “arrest në burg” si dhe për përcaktimin e natyrës së përkohshme të masës së sigurimit të dhënë na kuadër të kërkesës për ekstradim, duke mbështetur interpretimin e ligjit procedural edhe në parashikimet e nenit 39/2 të Kushtetutës si dhe legjislacionit ndërkombëtar të zbatueshëm, konkretisht Konventën Evropiane “Për ekstradimin, datë 13.12.1957, Konventën Evropiane “Për ndihmë të ndërsjelltë juridike në çështjet penale” ratifikuar me ligjin nr. 9871, datë 11.02.2008 dhe Marrëveshjen mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë si shtese e Konventës Evropiane “Për ekstradimin” 46.

- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.

Në disa prej vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë*) në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij. Konkretisht referohet vendimi unifikues nr.2, datë 29.01.2003 në lidhje me aplikimin e gjykimit të shkurtuar⁴⁷ dhe vendimi unifikues nr. 5, datë 30.10.2012 në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e nenit 16 të K.Pr.C që përcakton detyrimin e gjykatës për të bërë një përcaktim të saktë të fakteve dhe veprimeve objekt gjykimi, pa u lidhur me përcaktimin e propozuar nga palët⁴⁸. Në vendimet e tjera burim vlerësimi nuk rezulton të jetë referuar jurisprudencë relevante, kushtëzuar kjo edhe nga natyra jo komplekse e çështjeve të analizuara.

Gjithashtu konstatohet identifikimi i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijëve, në funksion të interpretimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, në vendimmarrjen e gjykatës për sa i përket të miturve në proces⁴⁹ dhe Konventës Evropiane “Për ekstradimin, datë 13.12.1957, Konventës Evropiane “Për ndihmë të ndërsjelltë juridike në çështjet penale” ratifikuar me ligjin nr. 9871, datë 11.02.2008 dhe Marrëveshjes mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë si shtese e Konventës Evropiane “Për ekstradimin” 50, në funksion të vlerësimit të kushteve ligjore për arrestimin dhe aplikimin e masave të sigurimit personal për efekt të procedurës së ekstradimit.

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës:

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Vendimi nr. 73, datë 26.01.2014.

⁴⁷ Vendimi nr. 712, datë 12.10.2015.

⁴⁸ Vendimi nr. 1178, datë 21.09.2015.

⁴⁹Vendimi nr. 1108, datë 06.10.2014 dhe vendimi nr. 712, datë 05.06.2014.

⁵⁰ Vendimi nr. 73, datë 26.01.2014.

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes gjyqtarja përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në disa raste duke i përmendur ato shprehimisht, dhe në disa raste të nxjerra nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur. Gjyqtarja njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit siç janë: fuqia provuese e akteve shkresore; mosdalja tej kërkimeve të padisë (*neni 6 i K.Pr.Civile*); identifikohet dhe reflektohet përmbushja e parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së palëve si një nga parimet kryesore të procesit të rregullt ligjor. Gjithashtu njeh dhe zbaton parimet e së drejtës materiale të cilat i shërbejnë dhe i vijnë në ndihmë interpretimit të ligjit dhe zgjidhjes së çështjes në themel si: parimi i interesit më të lartë të fëmijës⁵¹.

Gjyqtarja i kushton rëndësi interpretimit të ligjit të zbatueshëm, i cili në disa raste behet në mënyrë të pavarur, para aplikimit mbi faktet e çështjes, dhe në raste të tjera si pjesë e integruar analizës ligjore, së bashku me faktin përkatës. Në disa prej vendimeve të analizuara, konkluzioni arrihet nga analiza dhe vlerësimi i faktit, duke aplikuar drejtpërdrejt ligjin e zbatueshëm, pa një interpretim paraprak dhe të pavarur të tij, pa bërë zbrërthimin e të gjithë elementëve të normës (ligjit të identifikuar si të zbatueshëm), kjo nisur edhe nga natyra jo komplekse e disa çështjeve të trajtuara. Në pjesën tjetër të vendimeve të analizuara, analiza se si dispozitat ligjore relevante zbatohen mbi rrethanat faktike të provuara, nënkuptohet nga konkluzioni që ka arritur gjyqtarja pas citimit të ligjit, pasi mungon interpretimi i dispozitave përkatëse me qëllim dhënien e kuptimit të tyre para aplikimit mbi faktet konkrete⁵².

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi “mbi mesataren” në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Në rastet kur ka qenë e nevojshme, në mbështetje të interpretimit të normave, gjyqtarja ka zbatuar edhe praktikën gjyqësore unifikuese. Por në çështjet burim vlerësimi, nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi në interpretimin e normës. Në disa raste ajo referohet dhe aplikohet drejtpërdrejt mbi faktet e provuara në gjykim, pa u shoqëruar me një interpretim paraprak të qëllimit, elementëve përbërës dhe zbrërthimit të tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “mbi mesataren” duke u pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarës në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

⁵¹Po aty.

⁵² Vendimi nr. 484, date 14.04.2015.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi shumë të mira të arsyetimit ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të q{...}, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur në lidhje me zgjidhjen e çështjes në themel jepet i argumentuar, provat e mara në shqyrtim jo vetëm citohen por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre..”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të q{...}, të thjeshta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit. Gjyqtarja, përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe koncize. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Nuk konstatohet përdorimi në mënyrë permanente i shkronjës “ç” dhe “ë” në hartimin e vendimit. Nuk rezulton të jenë përdorur terma teknikë, apo fjalë që krijojnë konfuzion lidhur me kuptimin dhe kontekstin e përdorimit të tyre. Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, gjyqtarja i referon ato në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të thjeshta, të ndërthurura me njëra tjetrën dhe të kuptueshme. Vendimet janë të organizuar përgjithësisht në paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër dhe duke përdorur fjali hyrëse për paragrafë të caktuar, me qëllim orientimin e lexuesit për përmbajtjen e tyre.

Raporti mes pjesës përshkruese dhe analitike të vendimit, në varësi të kompleksitetit të çështjes, është i ndryshëm në vendimet e analizuara. Vërehet një rendësi me specifike në pjesën analitike të vendimit, në çështjet që paraqesin një natyrë më komplekse. Në shumicën e vendimeve të analizuara, kryesisht në vendimet civile që lidhen me marrëdhëniet e punës, evidentohet pas përshkrimit të faktit, citimi i një sërë dispozitash të Kodit të Punës, të identifikuar si ligj të zbatueshëm, por që jo në çdo rast citimi i tyre është bërë në shërbim të nevojës për t’ia nënshtruar atë interpretimit në pjesën vijuese të vendimit, pasi një pjesë e dispozitave të cituara, referohen dhe zbatohen drejtpërdrejtë mbi faktet e çështjes. Pavarësisht citimit të gjithë dispozitave që gjejnë zbatim të zgjidhjen e çështjes, përmbajtja e vendimeve të analizuara, duke qenë se përbëjnë kryesisht çështje me karakter jo tepër kompleks, nuk dëmton kuptueshmërinë e vendimit apo qartësinë e tij.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e thjeshtë dhe e kuptueshme e përdorur në arsyetim dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Paragrafët, në shumicën e vendimeve të analizuara, fillojnë me një fjali identifikuese (titull), e cila orienton përmbajtjen e tij. Mënyra e të shkruarit dhe organizimit të mendimit dhe shprehjes së tij, i jep vendimeve qartësi dhe kuptueshmëri, duke e bërë arsyetimin e vendimeve të rrjedhë në mënyrë logjike.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “shume e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mire organizuar dhe e standardizuar..”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që

juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, të ndryshme për vendimet civile nga ato penale, por të cilës i përmbahet në prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, analizën ligjore të çështjes dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtarja në rastin konkret ka një metodologji të qartë duke iu referuar pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit. Në pjesën hyrëse gjejmë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti i shqyrtimit, akuza ndaj të pandehurit/objekti i padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve ndërgjyqëse.

Pjesa përshkuese arsyetuese është e ndarë në disa nën pjesë dhe organizimi i saj në aspektin strukturor, ndryshon në vendimet civile nga ato penale.

Në vendimet civile gjyqtarja ka ndjekur një strukturë organizimi të vendimit, pothuajse të njëjtën, duke zbatuar metodën CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*). Konkretisht arsyetimi fillon me prezantimin e çështjes, përshkrimin në mënyrë të shkurtër të aspekteve procedurale lidhur me vlerësimin sa i përket juridiksionit dhe kompetencës së gjykatës, si dhe evidentimin e kërkesave procedurale të palëve siç është rasti i kërkesës për ndryshimin e objekti të padisë⁵³. Vetëm në një rast gjyqtarja ka ndjekur metodën IRAC⁵⁴ për organizimin e arsyetimit, duke ngritur pas paraqitjes së faktit dhe pretendimeve të palëve, pyetjet ligjore të vlerësuara thelbësore për zgjidhjen e çështjes, për të vijuar më pas me analizën dhe argumentimin ligjor në përgjigje të tyre dhe në zgjidhjen e çështjes në tërësi. Më pas në një nënndarje e cila identifikohet me një fjali prezantuese të përmbajtjes, përshkruhen dhe analizohen faktet e çështjes, duke integruar në përmbajtje edhe analizën e provave mbi të cilat faktet kanë rezultuar të provuara. Arsyetimi vijon me paraqitjen e pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, duke renditur secilin pretendim, dhe në disa raste edhe arsyetimin e secilës palë lidhur me pretendime të caktuara. Më tej arsyetimi vijon me paraqitjen e konkluzionit të gjykatës lidhur me pranimin apo rrëzimin e padisë, të parashtruar më një fjali, për të vijuar me identifikimin dhe citimin e neneve përkatëse të ligjit material dhe/ose procedural të zbatueshëm.

Pas citimit të ligjit të zbatueshëm, gjyqtarja vijon me paraqitjen dhe analizën e çështjes, duke integruar në të, kur është vlerësuar e nevojshme edhe interpretimin e pavarur të dispozitave ligjore, para aplikimit të tyre mbi faktet e çështjes. Në çështje të caktuara, pjesë e analizës ligjore është bërë edhe analiza e dispozitave procedurale në lidhje me barrën e provës apo çmuarjen e provave. Në pjesën e fundit të arsyetimit, gjyqtarja merr në analizë pretendimet e palëve, duke i analizuar ato në mënyrë specifike, kryesisht në vendimet civile, në raport me ato për çështjet

⁵³ Vendimi nr. 1178, datë 21.09.2015.

⁵⁴ Vendimi nr. 455, datë 07.04.2015.

familjare ku analiza e pretendimeve të palëve është pjesë e integruar e argumentimit ligjor të çështjes.

Në vendimet penale të analizuara⁵⁵, pjesa përshkuese arsyetuese fillon me përshkrimin e rrethanave procedurale dhe vlerësimin e gjykatës lidhur me juridiksionin dhe kompetence, si dhe kërkesën e të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar. Më pas, nëpërmjet një fjalie prezantuese (titull) arsyetimi vijon me përshkrimin e faktit penal, duke integruar provat e administruara gjatë gjykimit, për të vijuar me renditjen e provave dhe akteve të administruara, në kuadër të zhvillimit të gjykimit me procedurën e posaçme të gjykimit të shkurtuar. Pas renditjes së provave dhe akteve, gjyqtarja bën vlerësimin e saj lidhur me cilësimin juridik të veprës penale, duke konkluduar se ai është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe në prova, në dy rastet e analizuara, për të vijuar me citimin e nenit përkatës që përbën kualifikimin ligjor të akuzës ndaj të pandehurit (nenin 291 të Kodit Penal në të dy vendimet burim vlerësimi).

Pas citimit të dispozitës, gjyqtarja ka bërë një interpretim të pavarur të saj, duke evidentuar elementët e anës objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, për të vijuar arsyetimin me paraqitjen e argumenteve ligjore dhe përjashtjen e tij me faktet që rezultojnë nga provat e administruara në gjykim. Pjesa e dytë e analizës ligjore në vendimet penale burim vlerësimi, vijon me marrjen në analizë dhe vlerësimin e kriterëve të caktimit të llojit dhe masës së dënimit si dhe të aplikimit të dënimeve alternative, për të përfunduar me disponimin për masat e sigurimit dhe shpenzimet gjyqësore.

Në vendimin që lidhet me kërkesën për vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi⁵⁶, struktura e pjesës përshkuese arsyetuese ndjek të njëjtën logjikë, duke filluar me përshkrimin e fakteve dhe rrethanave të provuara, duke vijuar me pas me marrjen në analizë në mënyrë të veçantë të dy kërkimeve (kërkesës për vleftësim arresti dhe asaj për caktim mase sigurimi), duke integruar në arsyetim për secilin prej tyre, ligjin e zbatueshëm, interpretimin e tij kur është vlerësuar e nevojshme dhe vlerësimin e fakteve dhe rrethanave konkrete të çështjes në raport me parashikimet e ligjit, përfunduar me konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me secilën kërkesë.

Në pjesën e dispozitivit, si në vendimet civile ashtu edhe ato për çështje familjare, gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me pranimin/ rrëzimin e padisë, përcaktimin e detyrimeve të palës së paditur, në rastet kur padia është pranuar tërësisht ose pjesërisht, përcaktimi i cilësisë së vendimit si titull ekzekutiv, disponimin për shpenzimet gjyqësore dhe të drejtën e ankimit. Në vendimet civile që përmbajnë detyrime, gjyqtarja ka nxjerrë vendim për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit në referim të parashikimeve të nenit 511/1⁵⁷ të K.Pr.C. Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile si dhe nenit 17 pika 3 të ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006

⁵⁵ Vendimi nr. 712, datë 12.10.2015 dhe vendimi nr. 766, datë 22.10.2015.

⁵⁶ Vendimi nr. 73, datë 26.01.2014.

⁵⁷ Në nenin 511/1 të K.Pr.C, para ndryshimeve me ligjet nr. nr. 114/2016, datë 3.11.2016; nr. 38/2017, 30.3.2017, parashikohet se :” Për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 510 të këtij Kodi, urdhri i ekzekutimit lëshohet së bashku me vendimin gjyqësor dhe bëhet i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor vetëm pas konfirmimit nga kancelari. Kancelari konfirmon urdhrin e ekzekutimit vetëm pasi verifikon se vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë”.

“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar në rastin e vendimit gjyqësor të lëshimit të urdhrit të mbrojtjes.

Në vendimet penale, pjesa e dispozitivit përmban disponimin për deklarimin fajtor dhe dënimin e të pandehurit/caktimin e masës së sigurimit, masën e dënimit aplikimin e gjyqimit të shkurtuar, mënyrën e vuajtjes së dënimit, aplikimin e dënimit alternativ dhe detyrimet përkatëse, shpenzimet gjyqësore dhe hetimore, e drejta e ankimit si dhe vendi dhe data e shpalljes së vendimit.

Gjyqtarja ndjek rregulla të $q\{\dots\}$ në strukturimin e vendimit gjyqësor, ku gjyqtarja zbaton rregullat e shkrimit ligjor duke identifikuar faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, dhe konkluzionin e arritur.

KONKLUZIONE

Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ndjek një strukturë përgjithësisht të njëjtë në arsyetimin e vendimeve, të ndarë pjesë të cilat identifikohen nga tituj ose një fjali tematike kryesore. Metoda CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) e përdorur nga gjyqtarja në shumicën e vendimeve të analizuara, strukturon qartë mendimin dhe argumentimin logjik, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit. Nga ana tjetër, ndarja në pjesë, sipas përmbajtjes dhe ndarja e tyre në paragrafë të cilët kanë gjatësi mesatare dhe përmbajnë analizën e një elementi të caktuar të arsyetimit, e bën strukturën e vendimit funksionale dhe i jep lehtësi në lexim dhe kuptueshmëri, favorizuar kjo edhe nga natyra jo tepër komplekse e çështjeve të analizuara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GjEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.⁵⁸

⁵⁸ Vendimi i GjEDNJ, çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, duke treguar se gjyqtarja ka qenë e vëmendshme ndaj kërkesave të tyre....Në tekstet e vendimeve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga gjyqtarja. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërmjetme shoqërohen me referencë ligjore”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel i mirë arsyetimi, i qartë, i plotë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale të procedimit. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një organizim dhe zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil apo penal, duke u kujdesur në disa raste, për të identifikuar dhe analizuar koncepte ligjore specifike, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Gjyqtarja përshkruan dhe analizon në mënyrë të qartë faktet e çështjes, duke integruar në këtë analizë pjesë të provave ose faktet që rezultojnë prej tyre, çka e bën të qartë dhe të kuptueshme analizën e faktit dhe orienton me tej argumentimin logjik lidhur me pretendimet e palëve, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Në një vendim gjyqësor,⁵⁹ argumentimi ligjor rrjedh nga çështja/pyetja ligjore e parashtruar nga ana e gjyqtarës për zgjidhje në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, dhe hap pas hapi evidentohet argumentimi në të cilin ajo i përgjigjet çështjes me konkluzionin për zgjidhjen e saj. Në vendimet e tjera burim vlerësimi nuk është ndjekur kjo mënyrë në mënyrë të shprehuri, por arsyetimi dhe argumentimi ligjor bëhet duke iu përgjigjur konkluzionit që gjyqtarja arrin lidhur me objektin e padisë/cilësimin juridik të faktit penal, paraqitur në formë konkluzioni, menjëherë pas faktit dhe paraqitjes së pretendimeve të palëve.

Në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo asaj penale, gjyqtarja i kushton rëndësi evidentimit të marrëdhënies shkak – pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore të faktit penal me kualifikimin ligjor të tij.

Në vendimet e analizuara, kryesisht në ato civile, rezulton se gjyqtarja merr në analizë dhe i përgjigjet me argumente ligjore, të gjitha pretendimet e palëve në mënyrë të veçantë, duke evidentuar shpesh edhe parimin e barrës së provës në këto raste, për të konkluduar për bazueshmërinë ose jo të këtyre pretendimeve, në raport me faktet e provuara në gjykim dhe parashikimet e ligjit në raport me to.

⁵⁹Vendimi nr. 455, datë 07.04.2015

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi mbi mesataren, në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse. Në disa prej burimeve të vlerësimit, përmbajtja e arsyesimit të vendimit dominohet nga analiza dhe vlerësimi i faktit, pa përfshirë në të njëjtën masë edhe analizën se si konceptet, institutet apo dispozitat ligjore lidhen mes tyre dhe si ato zbatohen në rrethana të caktuara, kushtëzuar kjo edhe nga natyra jo komplekse e çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:

Në tërësi, referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares për treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “mbi mesataren” duke e pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtares në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	90

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se në katër raste është respektuar afati ligjor ose afati standard i gjykimit (shih dosjet 2,3,4 dhe 5). Në dosjen civile 1 afati standard është tejkaluar me 26 ditë, por nëse do të zbrisim afatin e lejes vjetore, atëherë edhe kjo çështje do të konsiderohej e gjykuar brenda afatit standard të gjykimit...Sa i përket gjykimit të çështjeve për 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, u konstatua se në të tre dokumentet 1,2 dhe 3, është respektuar afati standard i gjykimit.”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 1 vendimi të administruar për shkak të ankesave dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 1 vendimi të administruar për shkak të ankesave dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 3 prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e gjykimit. Konkretisht:

- (i) Çështja civile me objekt lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, për të cilën sipas nenit 16/1 të ligjit të posaçëm nr. 9669 datë 18.12.2006 «Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare», parashikohet një afat prej 15 ditësh për përfundimin e tyre. Referuar raportit analitik dhe dosjes së administruar, rezulton se çështja me nr. 23001-00448-62-2015(27), datë regjistrimi 02.03.2015, ka përfunduar me vendimin nr. 62-2015-900(22), datë 13.03.2015. Çështja ka përfunduar për 11 ditë, brenda afatit ligjor 15/ditë të parashikuar në ligjin e posaçëm nr. 9669 datë 18.12.2006 «Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare», i ndryshuar.
- (ii) Çështja e kategorisë kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake (*vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi*), për të cilën është parashikuar si afat ligjor për përfundimin afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të çështjes me nr. 61005-00131-62-2014(112), datë regjistrimi 25.01.2014, ora 14.45, deri në momentin e dhënies së vendimit nr. 62-2014-252(73), datë 26.01.2014, ora 11.00, ka kaluar një afat prej 21 ore e 15 minuta, brenda afatit ligjor 48 orë të parashikuar në nenin 259/2 të K.Pr.Penale për përfundimin e saj.
- (iii) Çështja me objekt “lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes” si dhe “verifikimi i urdhrit të mbrojtjes”, regjistruar në gjykatë me datë 06.10.2014, përfunduar me vendimin nr. 62-2014-3744(14), datë 23.10.2014 ka përfunduar për 17 ditë, brenda afati ligjor të parashikuar në nenin 20 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i

ndryshuar dhe kërkesa për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes është shqyrtuar brenda afatit ligjor 48 orë të parashikuar në nenin 18 të po këtij ligji.

Pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat vetëm për tre prej tyre parashikohet afat ligjor dhe për të tre çështjet rezulton se gjyqtarja ka përfunduar shqyrtimin e tyre brenda afatit ligjor, raporti i shprehur në përqindje për çështjet e përfunduara jashtë afatit ligjor të gjykimit është 0 %.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre, pasi nuk rezulton ndonjë prej 3/çështjeve të analizuara të ketë tejkaluar afatin ligjor të shqyrtimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi nuk ka çështje të përfunduara tej afatit ligjor.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me këtë tregues, konkludohet se nga ana e gjyqtarës janë respektuar standardet minimale kohore të gjykimit, duke iu referuar të njëjtit konkluzion të cituar në treguesin më sipër, për shkak se analiza e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet me afati ligjor dhe standard minimal kohor është bërë së bashku në raport.⁶⁰

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

⁶⁰Shih konkluzionin e Raportit të KLGJ-së, cituar në treguesin më sipër.

Për 15 çështjet e vëzhguara, nga të cilat për 12 prej tyre nuk parashikohet afat ligjor gjykimi, rezulton se përgjithësisht gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së⁶¹.

Referuar tre vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja, konstatohet se:

- (i) Në çështjen civile me nr. 21282-00008-62-2015(626), datë regjistrimi 12.01.2015, përfunduar me vendimin nr. 62-2015-437(181), datë 09.02.2015, rezulton se çështja ka përfunduar brenda një afati prej 28 ditësh, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së.
- (ii) Në çështjen civile me nr. 21279-00216-62-2015(780), datë regjistrimi 02.02.2015, përfunduar me vendimin nr. 62-2015-1308(484), datë 14.04.2015, rezulton se çështja ka përfunduar brenda një afati prej 2 muaj e 12 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së.
- (iii) Në çështjen civile me nr. 21264-00847-62-2015(1209), datë regjistrimi 22.04.2015, përfunduar me vendimin nr. 62-2015-2568(865), datë 23.06.2015, rezulton se çështja ka përfunduar brenda një afati prej 2 muajsh, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së.

Referuar 8 dosjeve të përzgjedhura me short,⁶² konstatohet se:

- (i) Në çështjen civile nr. 21264-00425-62-2015(908) regj, datë regjistrimi 25.02.2015, përfunduar me vendimin nr. 1178, datë 21.09.2015, rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda një afati prej 6 muaj e 26 ditë. Rezulton se në kohëzgjatjen e gjykimit përfshihet edhe muaji gusht në të cilin gjykatat zhvillojnë lejen vjetore, fakti ky i referuar edhe në raportin analitik të rivlerësimit⁶³. Nëse do të zbritet periudha e muajit gusht, rezulton se gjykimi ka përfunduar për **5 muaj e 26 ditë**, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së. Nëse periudha e muajit gusht do të përfshihet në kohëzgjatje, rezulton se standardi minimal kohor është tejkaluar me 25 ditë.
- (ii) Në çështjen civile (familjare) nr. 21001-01767-62-2014(1549) regj, datë regjistrimi 04.09.2014, përfunduar me vendimin nr. 1108, datë 06.10.2014, rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda një afati prej **27 ditë**, brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.
- (iii) Në çështjen penale me nr. 58345-02124-62-2015(1051) regj, datë regjistrimi 14.09.2015, përfunduar me vendimin nr. 766, datë 22.10.2015, rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda një afati prej **1 muaj e 7 ditë**, brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

⁶¹Sipas vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjyqimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.” Gjykimet civile në Gjykatën e Shkallës së parë jo më tej se 6 muaj dhe 4 muaj gjykimet familjare me palë kundërshtare”

⁶² Sikundër kemi analizuar nga 11 çështje të përzgjedhura me short, 3 prej tyre parashikojnë afat ligjor dhe 8 afat standard minimal kohor për përfundimin e tyre.

⁶³ Shih raportin analitik të rivlerësimit, faqe 16, faqe 516 e dosjes së rivlerësimit.

- (iv) Në çështjen civile (familjare) nr. 21001-01956-62-2015(1853) regj, datë regjistrimi 10.09.2015, përfunduar me vendimin nr. 1299, datë 13.10.2015, rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda një afati prej **1 muaj e 3 ditë**, brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.
- (v) Në çështjen penale me nr. 58324-02105-62-2015(1047) regj, datë regjistrimi 11.09.2015, përfunduar me vendimin nr. 712, datë 12.10.2015, rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda një afati prej **29 ditësh**, brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.
- (vi) Në çështjen civile (familjare) nr. 21009-00719-62-2014(933) regj, datë regjistrimi 22.04.2014, përfunduar me vendimin nr. 712, datë 05.06.2014, rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda një afati prej **1 muaj e 13 ditë**, brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.
- (vii) Në çështjen civile nr. 21260-00092-62-2016(667) regj, datë regjistrimi 18.01.2016, përfunduar me vendimin nr. 350, datë 23.03.2016, rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda një afati prej **2 muaj e 5 ditë**, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.
- (viii) Në çështjen civile nr. 21264-00365-62-2015(881) regj, datë regjistrimi 19.02.2015, përfunduar me vendimin nr. 455, datë 07.04.2015, rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda një afati prej **2 muaj e 15 ditë**, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 11 çështjet e analizuara, për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër rezultoi edhe më sipër, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor në fuqi, për secilën kategori çështjesh. Vetëm për çështjen civile nr. 21264-00425-62-2015(908) regj, datë regjistrimi 25.02.2015, përfunduar me vendimin nr. 1178, datë 21.09.2015, rezulton se gjykimi ka përfunduar për 6 muaj e 26 ditë, por në kohëzgjatjen e gjyqimit është përfshirë muaji gusht në të cilin gjykatat zhvillojnë lejen vjetore, fakti ky i referuar edhe në raportin analitik të rivlerësimit⁶⁴. Nëse do të zbritet periudha e muajit gusht, rezulton se gjykimi ka përfunduar për **5 muaj e 26 ditë**, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së. Për këtë arsye, gjykimi i çështjes në fjalë do të konsiderohet si i përfunduar brenda afatit standard.

Sa më sipër, raporti i çështjeve të përfunduara jashtë afatit standard minimal kohor, rezulton të jetë 0 %, pasi në çështjet e analizuara, nuk rezultojnë çështje të cilat të jenë përfunduara tej këtij afati.

KONKLUZIONE

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësive pasi ky afat është respektuar në të gjitha çështjet e analizuara.

⁶⁴ Shih raportin analitik të rivlerësimit, faqe 16, faqe 516 e dosjes së rivlerësimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi nuk rezulton asnjë çështje e përfunduar jashtë standardit minimal kohor.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit ;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e analizimit të aftësive profesional të KLGJ-së nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykatat e shkallës së parë në periudhën e vlerësimit.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.⁶⁵

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (11 çështjet e marra në analizë janë 6 çështje civile, 3 çështje familjare me palë kundërshtarë dhe 2 çështje penale themeli), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 6 çështjet në kategorinë e çështjeve “civile të përgjithshme me palë kundërshtarë”, rezulton të jetë **rreth 79.6 ditë ose 2 muaj e 19 ditë**, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 muaj për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 3 çështjet në kategorinë e çështjeve “familjare me palë kundërshtarë”, rezulton të jetë **rreth 31 ditë ose 1 muaj e 1 ditë**, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 4 muaj për gjykimin e çështjeve familjare në Gjykatën e Shkallës së Parë.

⁶⁵Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.”.

(iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjyqimit për 2 çështjet në kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezulton të jetë rreth **33 ditë ose 1 muaj e 3 ditë**, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 muaj për gjykimin e çështjeve penale krime në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 15 pikësh.

KONKLUZIONE

Sa më sipër, rezulton se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë, pasi rezulton se për të 3/kategoritë e çështjeve, koha mesatare është më e shkurtër se standardi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.*

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Ajo ka deklaruar se gjatë periudhës 08.10.2013-08.10.2016 i janë caktuar gjithsej 1730 çështje ku ka përfunduar 1604 çështje, duke mbartur në vitin e fundit 126 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 92.7 %. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, gjyqtare {...} ka përfunduar së gjykuari 1261 çështje nga të cilat 937 çështje civile, 324 çështje penale. Nga 937 çështje civile të gjykuara, 137 janë çështje civile themeli, 281 çështje familjare themeli dhe 420 janë kërkesa civile. Nga 324 çështje penale, 10 deklarohen të jene penale themeli (krime dhe kundërvajtje), ndërsa 314 janë kërkesa penale.*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Duke konsideruar periudhë vlerësimi periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2016 si dhe referuar të dhënave statistikore të dërguara nga gjykata për numrin e çështjeve të caktuara dhe atyre të përfunduara, rezulton se gjyqtarës i janë caktuar në total 1730 çështje. Gjyqtarja ka përfunduar

me vendim deri në tetor 2016, 1261 çështje sipas të dhënave statistikore. Ndërkohë që duke marrë në konsideratë numrin 126 çështje të mbartura për vitin 2017, rezulton që nga totali 1730 çështje, ajo ka përfunduar deri në 31.12.2016, 1604 çështje. Nga përlllogaritja e rendimentit sipas këtyre të dhënave, rezulton një normë likuidimi çështjesh 92.7 %, i njëjti tregues i llogaritur edhe gjatë procesit të rivlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, rendimenti në masën 92.7 % ose rreth 93 % përkon me nivelin e pikëzimit me 8 pikë. Nga ana tjetër, lidhur me standardin sasior për tre vitet e periudhës së vlerësimit, rezulton se nuk është tejkaluar me mbi 50 %, për të justifikuar një nivel më të lartë pikëzimi për këtë tregues⁶⁶. Sipas tabelave me të dhëna statistikore rezulton se gjyqtarja në periudhën 3/vjeçare të vlerësimit ka përfunduar 1261 çështje, nga të cilat 527 janë çështje me palë kundërshtare, mesatarisht 175 çështje për secilin vit.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 93 % që përkon me një pikëzim me 8 (tetë) pikë. Nga ana tjetër nuk ka të dhëna që mund të analizohen në drejtim të përcaktimit të një shkalle më të lartë pikëzimi, nga ato të përshkruara në Metodologjinë e Pikëzimit pasi standardi sasior nuk rezulton i tejkaluar me mbi 50%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja pikëzohet me 8 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

⁶⁶ Lidhur me standardin sasior të punës, në vendimin nr. 261/2, viti 2010 të KLD-së parashikohet standardi sasior si më poshtë: d. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit familjar, jo më pak se 200 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje familjare. e. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo me pak se 120 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare. ë. Gjyqtari i gjykatës së shkallës parë, i dhomës civile e penale, shqyrton jo më pak se 400 çështje të natyrës kërkesa (civile ose penale) me ose pa palë të interesuara.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar Raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja {...} i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore, duke respektuar në të gjitha rastet afatet ligjore. Konkretisht arsyetimi i vendimeve gjyqësore është kryer 8 ditë nga shpallja (dosja 1), për 2 ditë nga shpallja (dosja 2), për 3 ditë nga shpallja (dosja 3), për 4 ditë nga shpallja (dosja 4) dhe 1 ditë nga shpallja (dosja 5).”*

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10/ditor i ankimit ndaj vendimit penal. Sa i përket vendimeve civile, në nenin 308 të K.Pr.C⁶⁷, para ndryshimeve me ligjin nr.38/2017, parashikohej afati 10 ditor për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Për këtë arsye, për çështjet civile afati i dorëzimit të vendimit do të vlerësohet në raport me afatin 10 ditor, por gjithsesi duke konsideruar edhe afatin 15 ditor të ankimit, sipas legjislacionit procedural civil të kohës.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

(i) Çështja civile nr. 21264-00425-62-2015 (9028) regj them, datë 25.02.2015 regjistrimi, përfunduar me vendimin nr. 1178, datë 21.09.2015. Vendimi është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 29.09.2015, **8 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.

(ii) Çështja civile (familjare) me nr. 21001-01767-62-2014 (1549) regj them, datë 04.09.2014, e përfunduar me vendimin nr. 1108, datë 06.10.2014. Vendimi është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 08.10.2014, pra **2 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.

⁶⁷ Ne nenin 308 pg 2 të K.Pr.C, në fuqi në periudhën e rivlerësimit, parashikohej se :” *Në çështje të ndërlukuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se dhjetë ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në pesë ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai ia beson këtë njërit prej anëtarëve të trupit gjykues.”*

- (iii) Çështja civile (familjare) me nr. 23001-00448-62-2015 (27) regj them, datë 02.03.2015, e përfunduar me vendimin nr. 62, datë 13.03.2015. Vendimi është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore **3 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (iv) Çështja penale me nr. 58345- 02124- 62- 2015 (1051) regjistri, datë regjistrimi 14.09.2015, përfunduar me vendimin nr. 766, datë 22.10.2015. Vendimi është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 26.10.2015, pra **4 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (v) Çështja penale (kërkesë penale e hetimit paraprak) me nr. 61005-00131-62-2014(112) regjistri, datë 25.01.2014, përfunduar me vendimin nr. 73, datë 26.01.2014. Vendimi është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 27.01.2014, **1 ditë nga shpallja e vendimit** duke respektuar afatin ligjor.

Sipas fletëve të regjistrimit të dorëzimit të dosjeve, dërguar nga Gjykata së bashku me 6 dosjet e përzgjedhura me short, rezulton se:

- (vi) Çështja civile (familjare) me nr. 23001-02103-62-2014(13) regjistri, datë regjistrimi 06.10.2014, përfunduar me vendimin nr. 3744(14), datë 23.10.2014. Vendimi është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 24.10.2014, **1 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (vii) Çështja civile (familjare) me nr. 21001-1956-62-2015(1853) regjistri, datë regjistrimi 10.09.2015, përfunduar me vendimin nr. 4245(1299), datë 13.10.2015. Vendimi është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 16.10.2015, **3 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (viii) Çështja penale me nr. 58345- 02105- 62- 2015 (1047) regjistri, datë regjistrimi 11.09.2015, përfunduar me vendimin nr. 712, datë 12.10.2015. Vendimi është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 14.10.2015, pra **2 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (ix) Çështja civile (familjare) me nr. 21009-00719-62-2014(933) regjistri, datë regjistrimi 22.04.2014, përfunduar me vendimin nr. 2101(712), datë 05.06.2014. Vendimi është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 10.06.2014, **5 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (x) Çështja civile me nr. 21260-00092-62-2016(667) regjistri, datë regjistrimi 18.01.2016, përfunduar me vendimin nr. 1295(350), datë 23.03.2016. Vendimi është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 30.03.2016, **7 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (xi) Çështja civile me nr. 21264-00365-62-2015(881) regjistri, datë regjistrimi 19.02.2015, përfunduar me vendimin nr. 1227(455), datë 07.04.2015. Vendimi është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datë 10.04.2015, **3 ditë nga shpallja e vendimit**, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit:

-

- për kategorinë penale krime për 2 dosje është 3 ditë;
- për kategorinë civile themeli, për 3 dosje është 6 ditë;
- për kategorinë familjare me palë kundërshtare, për 5 dosje, është 2.8 ditë;

- për kategorinë kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak, për 1 dosje, është 1 ditë.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Në 5 çështjet e vëzhguara gjykimet kanë përfunduar me 13 seanca (dosja 1), me 3 seanca (dosja 2), me 1 seancë (dosjet 3 dhe 5), dhe me 3 seanca (dosja 4). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 21 seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 7 seanca nuk kanë qënë produktive. Pengesë për 7 seancat gjyqësore joproduktive janë bërë : mungesa e palëve, mungesa e palëve për shkaqe shëndetësore, shtyrja e seancës për të marrë prova të reja, etj....Seancat e vëzhguara përgjithësisht janë celur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre, por në rastet kur seanca ka filluar me vonëse, në procesverbal është shënuar ora e fillimit apo e mbylljes së seancës përgatitore apo gjyqësore. Për tu vlerësuar është fakti që të gjitha seancat gjyqësore të vëzhguara janë regjistruar në sistem audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit të gjyqimit...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, të gjitha çështjet vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, me përjashtim të dosjes nr. 5 që i takon kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se: Numri i seancave gjyqësore në 4 çështjet e vëzhguara rezulton që të ketë qene i ndryshëm. Gjykimet kanë përfunduar me 7 seanca gjyqësore (shih dosjen 1), me 2 seanca (shih dosjen 2), me 1 seancë (shih dosjen 3), me 3 seanca gjyqësore (shih dosjen 4). Seancat rezultojnë të jenë shtyrë më kërkesë të palëve, për të përgatitur prapësimet me shkrim, për të siguruar prezencën e paditësit për tu pyetur personalisht në seancë, për ti lënë kohë palëve për të paraqitur prova, për të përgatitur diskutimin përfundimtar, për shkak të kërkesave të tyre për shtyrje për shkaqe të përligjura, për ti lënë kohë ekspertës për përgatitjen e aktin të ekspertimi psikologjik, etj. Të gjitha rrethanat nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Orari i fillimit dhe mbarimit të seancës gjyqësore është dokumentuar saktësisht në procesverbal. Seancat janë planifikuar brenda afateve të shkurtra, duke respektuar afatin procedural 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.P për çështjet penale dhe brenda afateve të arsyeshme, përgjithësisht të shkurtra, në çështjet civile. Gjyqtarja ka monitoruar njoftimet e palëve për të shmangur vonesat në dërgimin e tyre apo për të siguruar zhvillimin korrekt të gjyimit.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

Në një çështje penale (penale krime) rezulton se numri i seancave të zhvilluara është 4 seanca gjyqësore (shih dosjen 8). Seancat janë shtyrë për ti lënë kohë prokurorit për të përgatitur diskutimin përfundimtar me shkrim, për arsye të mungesës së gjyqtarës për shkaqe shëndetësore, për ti lënë kohë avokatit të caktuar kryesisht për tu njohur me aktet. Në çdo rast seancat janë caktuar brenda afateve të shkurtra, pa tejkalluar në asnjë rast afatin procedural të parashikuar në nenin 342/2 të K.Pr.P.

Në dosjet civile të vëzhguara, janë zhvilluar përkatësisht 3 seanca gjyqësore (dosja 7), 2 seanca gjyqësore (dosja 9), 3 seanca gjyqësore (dosja 10) dhe 3 seanca (dosja 11). Në këto çështje rezulton se seancat gjyqësore janë shtyrë për shkaqe të tilla si: dhënien e kohës ekspertës psikologe për të kryer aktin e ekspertimit, për ti lënë kohë palës së paditur për të paraqitur prova, me kërkesë të palëve për ti lënë kohë për të paraqitur prapësimet me shkrim. Seancat janë planifikuar brenda afateve të shkurtra kohore.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli, civile themeli dhe familjare me palë kundërshtare) varion nga 1 deri në 7 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 4.3 seanca gjyqësore në çështjet civile me palë kundërshtare, 1.8 seanca gjyqësore për çështjet familjare me palë kundërshtare dhe 3.5 seanca gjyqësore në çështje penale themeli. Në tërësi, për 10 çështjet e vëzhguara, numri mesatar i seancave është 2.9 seanca për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (me short për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (*nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile dhe neni 333 e vijues dhe 342/2 të K.Pr.Penale, nenin 132 të Kodit të Familjes dhe parashikimet e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar*). Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të q{...} për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si njoftimit i palëve, dhënie kohë palëve për të paraqitur prova, përgatitur prapësimet apo diskutimin përfundimtar me shkrim, për ti dhënë kohë mbrojtësve për tu njohur me aktet, për përgatitjen e aktin të ekspertimit, etj. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.P, ndërsa në çështjet civile, pavarësisht se nuk rezulton të jetë parashikuar në ligjin procedural të kohës një afat për shtyrjen e seancave gjyqësore, ato në çdo rast janë planifikuar brenda afateve të arsyeshme dhe përgjithësisht më të shkurtra se 15 ditë.

Referuar sa më sipër, për treguesin e *“numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”*, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve⁶⁸ të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 2.9 seanca, dhe në çdo rast gjyqtarja ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, numri mesatar i seancave gjyqësore është 3 seanca (2.9) dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive është e lartë dhe pikëzohet në nivel maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 2.9 seanca dhe gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie në planifikimin dhe menaxhimin e seancave dhe marrjen e masave për shmangien e seancave jo produktive.

⁶⁸Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përfshirë ato pa palë ndërgjyqëse”.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...}, ka shfaqur aftësi të mira për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e vëzhguara....Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore/pajtimit apo gjyqësore (shih dosjet 1-5). Në një çështje themeli të vëzhguar gjyqtarja ka kryer rregullisht veprimet përgatitore (dosja 1) apo veprimet e pajtimit në çështjet familjare zgjidhje martese (dosja 2). Veprimet përgatitore dhe ato të pajtimit janë dokumentuar rregullisht me procesverbal. Aftësi të mira janë konstatuar edhe në gjykimin penal (shih analizën e dosjeve 4 dhe 5).”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtare dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Gjyqtarja në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore/pajtimit/gjyqësore dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë ose deri në 3 ditë pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës së pajtimit/përgatitore/ gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore për seancat gjyqësore si dhe në procesverbalin e seancës përgatitore/pajtimit, mbajtur nga vetë gjyqtarja.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se përgjithësisht në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke urdhëruar njoftimet përkatëse për palët. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë zhvillimit të seancave përgatitore/pajtimit/gjyqësore janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*) ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 355 e vijues të K.Pr.Penale*). Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me

ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas rregullave procedurale, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje te vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa 2 deri në 10 min., që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Në çdo rast që seanca gjyqësore ka filluar me disa minuta vonesë, në procesverbalin e seancës gjyqësore evidentohet shkakun i vonesës i relatuar nga gjyqtarja.

Distancat kohore midis seancave janë të arsyeshme dhe në raport me shkakun për të cilin seanca është shtyrë si dhe duke respektuar në çdo rast afatin procedural të përcaktuar në nenin 342/2 të K.Pr.P si dhe afate të arsyeshme (më të shkurtra se 15 ditë) në çështjet civile. Në çështjet për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat ligjor shqyrtimi (kërkesa penale të hetimit paraprak dhe çështje për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, verifikimin e tij apo lëshimin e urdhrit të mbrojtjes) gjyqtarja ka planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve ligjore seancat për gjykimin e këtyre çështjeve. Edhe në rastet e shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale⁶⁹ në çështjet me afat ligjor gjykimi, seancat vijuese janë planifikuar brenda afateve shumë të shkurtra (disa ditë) duke mundësuar përfundimin e gjykimi brenda afatit ligjor në çdo rast të vëzhguar.

KONKLUZIONE

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe eficientës së treguar nga gjyqtari në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me eficientë veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me eficientë dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

⁶⁹Shih dosjen që i përket vendimit nr. 14, datë 23.10.2014 dhe vendimit nr. 22, datë 13.03.2015.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportit analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar gjyqtarja {...} ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore...Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në pesë dosjet e vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin kronologjik (sipas datës së aktit ose radhës së depozitimit të tij). Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme duke përmbajtur aktin e shortit, kërkesë padinë/kërkesën penale për gjykimin e çështjes, aktet e përfaqësimit të palëve, provat e paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse, njoftimet e palëve, parashtrimet dhe diskutimet me shkrim të palëve, vendimin e kalimit të çështjes në seancë përgatitore/pajtimi, seancat përgatitore të zhvilluara sipas datave dhe me pas vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet për çdo seancë, procesverbalin e seancave gjyqësore sipas datave, vendimin përfundimtar të gjykatës dhe vendimin për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për çështjes civile.

Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLUZIONE

Në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara, të renditura në mënyrë kronologjike dhe orientojnë drejt lexuesin për vendndodhjen e tyre, duke krijuar mundësi për tu shfrytëzuar me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar si kërkesë padia apo kërkesa penale për gjykim, fashikulli i gjykimit, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat, vendimi përfundimtar, etj.”*

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (vendimi për caktimin e seancës së pajtimit/përgatitore/gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore/pajtimi apo gjyqësore, vendimet gjyqësore të të arsyeuara në rastin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, vendimi përfundimtar dhe vendimi për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit në çështjes civile në të cilat vendimi gjyqësor përbën titull ekzekutiv) si dhe aktet e paraqitura nga palët (aktet e përfaqësimit të palëve si prokura, autorizime, padia dhe provat e administruara në të cilën përfshihet edhe akti i ekspertimit nëse është lejuar marrja e provës me ekspert, , parashtrimet me shkrim dhe diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONE

Në tërësi, dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë, nuk konstatohen mungesa aktesh dhe as konstatohet në dosje dokumentacion i cili nuk i përket çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	98

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës {...}. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk konstatohen të dhëna negative në këtë aspekt.”⁷⁰*

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr. 5065/4 prot, datë 30.10.2020 dhe praktikes qe i përket ankesës së vitit 2014, rezulton se kjo ankesë është verifikuar lidhur me pretendimet për zvarritje të gjykimit dhe është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje nga ana e gjyqtarës. Referuar analizës dhe konkluzionit të arritur lidhur me trajtimin e kësaj ankesë, lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit për këtë çështje. Nuk konstatohet evidentimi i elementëve që tregojnë cenim të etikës në punë nga ana e gjyqtarës {...}. Në relacionin e hartuar nga Inspektorati i KLD-së lidhur me trajtimin e ankesës, nuk rezulton të jenë evidentuar

⁷⁰Shih fq 38 dhe 39 të Raportit.

elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD –së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 329, datë 06.01.2021 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, rezulton se KPK nuk ka evidentuar elementë që mund të ndikojnë në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarit, duke konkluduar në tërësi lidhur me kriterin e aftësive profesionale dhe të kontrollit të figurës se : *“...në vlerësim të kriterit të kontrollit të figurës, në tërësi, Komisioni arrin në përfundimin se për sa kohë nuk janë gjetur fakte apo rrethana që mund të çonin në një konkluzion të ndryshëm nga ai i arritur nga DSIK-ja, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar i përshtatshëm për vijimin e detyrës..... Në këto kushte, trupi gjykues, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shqyrtuara më herët nga KLGJ si dhe me denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional, mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka arritur një nivel mëse kualifikues lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse...”*

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtares për treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga pesë dosjet e vëzhguara , konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj nga çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Për këtë gjyqtare gjatë periudhës së rivlerësimit është paraqitur vetëm një ankesë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë e cila, pas verifikimit, rezultoi e pabazuar.”.*

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së dhe KLGJ-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 Tetor 2013 - 8 Tetor 2016”, për gjyqtaren {...} është paraqitur vetëm një ankesë e cila është verifikuar dhe është pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se nuk kanë rezultuar shkelje nga ana e gjyqtarës në raport me pretendimin për zvarritje të gjykimit pasi çështja për të cilën është paraqitur ankesa ka përfunduar brenda afateve standarde në fuqi.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se: “...Në konkluzion, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2010, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm vjetor dhe përfundimtar ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm pozitiv, pa mungesa të burimeve financiare.”.

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarit, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pa bazuara duke konkluduar se: “...Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligj zbatuese, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte të reja lidhur me këtë kriter. Për rrjedhojë – në vijim të hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në dokumentet e administruara – në vlerësim të kriterit të kontrollit të figurës, në tërësi, Komisioni arrin në përfundimin se për sa kohë nuk janë gjetur fakte apo rrethana që mund të çonin në një konkluzion të ndryshëm nga ai i arritur nga DSIK-ja, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar i përshtatshëm për vijimin e detyrës..”

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarës {...}.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës për treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se: “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për vetë gjyqtaren {...} nuk u konstatua asnjë kërkesë për përjashtimin e saj nga gjykimi në 5 dosjet e vëzhguara. Nga ana tjetër, në asnjë nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk lidhet me grupe në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elementëve të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në të 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit ;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në 3 vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe aktet e 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për

këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se: “..Për vetë gjyqtaren {...} nuk u konstatua asnjë kërkesë për përjashtimin e saj nga gjykimi në 5 dosjet e vëzhguara.”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarës, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (*burimet arkivore të KLD/KLGJ*) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës {...} në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës. Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);
-

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se: “Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore dhe gjyqësore ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet

shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja {...} ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit. Nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale për të cilat gjyqtarja vihet në dijeni për shkak të funksionit. Në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton të ketë pasur të dhëna me karakter sensitiv apo personal. Gjithashtu, nga burimet e tjera të vlerësimit nuk ka asnjë të dhënë apo indicie për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të palëve apo pjesëmarrësve në gjykim.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares për treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtares {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk janë evidentuar raste të shpeshta që të këtë pasur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore apo vonesa në arsyetimin e vendimeve, gjë që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të

të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, vlerësohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares për treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit të papërshtatshëm, përjashtimit social, etj, duhet të vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtarit me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, vlerësohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar analitik të rivlerësimit, vërtetimit nr. 942 prot., datë 25.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitetet trajnuese si me poshtë:

- (i) Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 9 (nëntë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 15 ditë trajnimi.

Sipas parashikimeve të nenit 5, pika 3 të Ligjit për Statusin *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.* Në rastin konkret gjyqtarja ka marrë pjesë në 9 aktivitete trajnuese të shtrira në 15 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimale (15 deri në 120 ditë në 3/vite) të përcaktuara nga Ligji për Statusin, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e saj dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së saj pasi rezultojnë të jenë aktivitete me tema të së drejtës procedurale dhe materiale civile dhe penale.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës civile dhe familjare etj., gjithsej 9 aktivitete të zhvilluara për 15 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është nga 15-120 ditë duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, rezulton se ajo është angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë pjesëmarrëse ndërkohë që nuk rezultojnë angazhime të gjyqtares në cilësinë e trajnuesit apo lehtësuesit në aktivitete të trajnimit vazhdues të Shkollë së Magjistraturës apo në aktivitete të tjera jashtë këtij programi.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari. Në rastin konkret, për gjyqtaren {...} nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin në veprimtari të tilla, për pasojë, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësues pranë Shkollës së Magjistraturës.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë, pasi nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndër institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se, për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi.

Referuar sa më sipër, për treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtares dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	90	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	379	Shkëlqyeshëm